



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 3/2021 (JR)
Datë 14.01.2021

Vendim nr. 9 (JR)
Datë 23.03.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 23.03.2021, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 3/2021, datë 14.01.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Bilbil Mete, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 4, 5, 35, 42, 48, 52, 122, 148 e vijues, si dhe germat “F” dhe “G” të Aneksit të saj; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nenet 1, 6, 7, 13, 14; Kodi i Procedurës Civile, nenet 111, 442-471; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 1-21, nenet 108-114, nenet 128-133; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62-64; ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 31 dhe 92; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 64 dhe 164; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 44, 46, 48 e vijues.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi shfuqizimin e pikës nr. 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 322, datë 10.12.2020, me numër akti 236, si të pabazuar në ligj e në prova, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 322, datë 10.12.2020, vendosi:
 1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Bilbil Mete, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë (përfunduar në datën 30.10.2020).*
 2. *Ndalimin e emërimit të z. Bilbil Mete si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare [...].*

II. Shkaqet e ankimit

2. Kundër vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Bilbil Mete, duke kërkuar shfuqizimin e pikës nr. 2 të dispozitivit të vendimit, si të pabazuar në ligj e në prova.
3. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se referuar nenit 164, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016, nuk gëzonte statusin e magjistratit dhe nuk duhet t’i ishte drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë me kërkesën për mbarimin e statusit pasi nuk e ka gëzuar asnjëherë këtë status, për rrjedhojë vendimi i KLP-së dhe çdo vendim tjetër i lidhur me të është jokushtetues, i kundërligjshëm dhe i pavlefshëm.
4. Komisioni ka shkelur parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, pasi subjekti nuk gëzonte statusin e magjistratit, dhe është penalizuar pa ligj dhe se pika 2 e dispozitivit të vendimit bie ndesh me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut e, për rrjedhojë, është e pavlefshme.
5. Sipas subjektit, e drejta për të dalë në pension është barazuar pa asnjë argument ligjor me dorëheqjen, çka është e papranueshme. Duke qenë se mungon dorëheqja, nuk mund të zbatohet as parashikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, siç ka vendosur Komisioni. Dalja në pension nuk mund të barazohet me dorëheqjen sepse janë dy koncepte krejt të ndryshme që nuk mund të qëndrojnë njëherazi e përjashtojnë njëra-tjetrën. Dorëheqja është vullnet, kurse dalja në pension është për shkak të ligjit.
6. Subjekti pretendon se ka dalë në pension në bazë të nenit 52 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke respektuar të drejtën e pakufizuar për këtë veprim, të cilin nuk mund ta kufizojë as arsyetimi i gabuar i Komisionit dhe askush tjetër. Komisioni, sipas subjektit, e ka dënuar pa

faj dhe pa asnjë përgjegjësi, në mënyrë paradoksale dhe jologjike, ka “dënuar” moshën, Kushtetutën dhe ligjin për sigurimet shoqërore.

7. Nga analiza e përmbajtjes së pikës 17 të vendimit të Komisionit, sipas subjektit ngrihen disa pyetje: a) *Përse dhe për cilat shkaqe ligjore ndërprerja e procesit të rivlerësimit sjell si pasojë penalizimin [...] e magjistratit me humbjen e së drejtës për t’u emëruar në organet e drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare?* b) *Përse dhe për cilat shkaqe ligjore dhe objektive ndërprerja barazohet me dorëheqjen, që kërkon si kusht Aneksi i Kushtetutës për këtë penalizim?* c) *Përse në pikën 17 të pjesës arsyetuese të vendimit, Komisioni harron atë që vetë shënon në pikën 16 të këtij arsyetimi, “E drejta e çdo shtetasi për të dalë në pension është e pakufizuar”?* – dhe d) *Çfarë përfiton magjistrati [...] nga e drejta e pakufizuar për të dalë në pension?* Përgjigjet e munguara të këtyre pyetjeve, sipas subjektit, tregojnë që vendimi i Komisionit është i paligjshëm, kontradiktor dhe i paarsyetuar.
8. Arsyetimi në pikën 18 të vendimit është i kundërligjshëm, i padrejtë dhe i papranueshëm, pasi në nenin 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, para ndryshimeve me ligjin nr. 48/2019, thuhej që statusi i magjistratit mbaron kur “mbush moshën e pensionit” dhe me ndryshimet kur “mbush moshën 67 vjeç”. Nisur nga fakti që pjesa e parë e fjalisë – “Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur” – nuk ndryshon, tregon qartë që ndryshimet kanë të bëjnë me zgjatjen e moshës së statusit, por jo me zgjatjen e moshës së pensionit që me ligjin themelor të sigurimeve shoqërore ka qenë dhe është 65 vjeç. E drejta e magjistratit për të vazhduar ushtrimin e funksionit pas moshës 65 vjeç, nuk mund të interpretohet si detyrim për të ushtruar funksionin, por si një zgjedhje e tij personale.
9. Referuar parashikimit në nenin 52 të Kushtetutës, çdo ndryshim ligjor i pretenduar për zgjatjen e moshës së pensionit për magjistratët do të binte ndesh me Kushtetutën, sepse sistemi i caktuar me ligj për sigurimet shoqërore është i përcaktuar në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993. Nëse me ligjin me të cilin janë bërë ndryshime për statusin për magjistratët, do të ishte ndryshuar realisht mosha e pensionit për prokurorët dhe gjyqtarët, sikurse pretendohet në vendimin e Komisionit, ky ndryshim do të përbënte diskriminim ligjor për shkak të profesionit dhe do të binte ndesh jo vetëm me Kushtetutën, por edhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
10. Subjekti pretendon se aktet në lidhje me pensionin e pleqërisë tregojnë se ai është i vetëlarguar nga sistemi në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit për sigurimet shoqërore. Për pasojë, i vetëlarguari nuk mund të penalizohet apo të dënohet me përzënie nga sistemi, siç përcaktohet në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionit.
11. Nëse ndryshimet e ligjit nr. 96/2016 do të kishin zgjatur moshën e pensionit, ato do të binin ndesh jo vetëm me nenin 52 të Kushtetutës por edhe me nenet 139, pika 1, germa “a”; 147/b, pika 1, germa “a”; 147/dh, pika 1, germa “a”; 148/c, pika 1, germa “a”; 149/b, pika 1, germa “a” e saj. Sipas ligjit në fuqi për statusin, për funksionarët e drejtësisë është zgjedhje e tyre personale ushtrimi i funksioneve tej moshës 65 vjeç, zgjedhje të cilën ata e pranojnë qëkur shprehin vullnetin e tyre në kërkesën për të ushtruar funksionet respektive.
12. Subjekti pretendon se edhe nëse ndryshimet ligjore të ligjit për statusin kanë zgjatur moshën e pensionit, ligji për sigurimet shoqërore do të kishte dhe ka epërsi zbatimi, si ligji themelor në

këtë fushë, zbatimi i të cilit nuk mund të kushtëzohet nga asnjë ligj tjetër derisa ligjit në fuqi për sigurimet shoqërore i referohet dhe vetë Kushtetuta në dispozitat e përcaktuara më sipër.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

13. Subjekti i rivlerësimit Bilbil Mete, në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme e, për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
14. Komisioni ka vendosur të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Bilbil Mete, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë (përfunduar në datën 30.10.2020) dhe ndalimin e emërimit të tij si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
15. Nga analizimi i akteve shkresore të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se nga Komisioni ka filluar hetimi administrativ për subjektin e rivlerësimit Bilbil Mete më datë 15.11.2018. Më datë 27.07.2020, subjekti i rivlerësimit përcjell përgjigjet plotësuese (nr. 2) të pyetjeve të pyetësorit, të dërguara nga Komisioni më datë 09.04.2020, që sipas subjektit nuk ishin dërguar më parë për shkak të përgjigjeve të vonuara nga institucionet e ndryshme, si dhe kufizimit të lëvizjeve të personave, si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19. Në përgjigje të pyetjeve të Komisionit (*e-mail, datë 05.08.2020*) për të dhënë shpjegime nëse përgjigjet e pyetësorit ishin të plota dhe përfundimtare, me qëllim përfundimin e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit (*e-mail, datë 10.08.2020*) informon se përgjigjet nuk janë përfundimtare, pasi ai nuk e ka pasur të mundur të marrë: i) dokumente të detajuara mbi të ardhurat e bashkëshortes së djalit për periudhën paramartesore, për shkak të Covid-19; ii) dokumente lidhur me aktivitetin tregtar të motrës në qytetin e Ersekës, pasi nuk është ngritur komisioni për hapjen e dokumenteve të organeve tatimore të arkivuara në atë qytet; iii) kopje të kontratave të shitjes nga ish-banorë të pallatit ku ka jetuar në Pogradec, shitur në shuma të përafërta me ato të deklaruara nga subjekti. Përpos sa më sipër, në këtë komunikim, subjekti sqaron se: [...] pas 75 ditësh plotësoj moshën e pensionit, 65 vjeç, dhe pas disa ditësh do të paraqit para jush kërkesën që do të drejtoj në organet kompetente për dokumentet që duhet të plotësoj për daljen në pension, pasi nuk dëshiroj të vazhdoj të punoj pas kësaj moshe.
16. Më datë 25.09.2020, subjekti i rivlerësimit i drejton Këshillit të Lartë të Prokurorisë kërkesën sipas së cilës: [...] bazuar në nenet 31 dhe 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në datën 25.10.2020, mbush moshën e pensionit 65 vjeç. [...] Në këto kushte, bazuar në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkoj nga ana juaj që, për shkak të daljes në pension, brenda afateve ligjore, të deklarohej për mua mbarimi i statusit të magjistratit.
17. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), me vendimin nr. 214, datë 15.10.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, mbështetur në nenin 64, pika 1, germa “a” dhe nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit, për shkak dorëheqje, të magjistratit Bilbil Mete, aktualisht prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, Tiranë. 2. Dorëheqja jep efektet në datën 31.10.2020 [...]. Ky vendim i përcillet subjektit të rivlerësimit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me shkresën nr. {***} prot., datë 20.10.2020. Vendimi nr. 214, datë 15.10.2020, i KLP-së është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Administrativ (çështja nr. {***} regjistri, datë 03.11.2020), me palë

ndërgjyqëse, paditës Bilbil Mete, i paditur Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe palë e tretë Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë. Objekti i padisë: 1. *Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 214, datë 15.10.2020, me të cilin është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit për mua, ankuesin.* 2. *Publikimin e vendimit të ndryshuar dhe plotësuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.* Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin nr. 107, datë 23.12.2020, vendos rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër këtij vendimi.

18. Subjekti i rivlerësimit, pas marrjes në dijeni të vendimit të KLP-së, më datë 30.10.2020 i kërkon Komisionit të rezervojë të drejtën për të shqyrtuar dokumentet dhe provat për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit pasi të shprehet më parë Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë. Po në të njëjtën datë, Komisioni përgjigjet se ishte në pritje që vendimi i KLP-së të merrte formë të prerë (më 31.10.2020) *për të vijuar me ndërprerjen e procesit të vetingut sipas parashikimeve ligjore.* Komisioni i rikujton në këtë komunikim subjektit të rivlerësimit se ishte shortuar në vitin 2018 dhe Komisioni ishte gati për të mbyllur procesin e rivlerësimit dhe se procedurat ishin ndërprerë për shkak të njoftimit të subjektit se do të tërhiqej nga funksioni për shkak të daljes në pension dhe se aktualisht ishte në pritje që vendimi të merrte formë të prerë.
19. Më datë 27.11.2020, në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni njofton subjektin se gëzon të drejtën për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore që do të zhvillohej më datë 02.12.2020, duke e informuar se nëse nuk e ushtronte këtë të drejtë, procesi i rivlerësimit do të ndërpritej pa u zhvilluar një seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit, me anë të *e-mail-it* të datës 28.11.2020, i përgjigjet Komisionit se nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën për t'u dëgjuar, me argumentin që kundërshtimet për vendimin e KLP-së i ka parashtruar në kërkesëpadinë e paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe me faktin e daljes në pension pleqërie konform ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993.
20. Nisur nga rrethanat e mësipërme, si shprehja e vullnetit të subjektit për të ndërprerë marrëdhëniet e tij të punës, bërja prezent para Komisionit 75 ditë përpara këtij fakti se nuk dëshironte të punonte pas moshës 65 vjeç, si dhe formalizimi më pas me paraqitjen e kërkesës drejtuar KLP-së për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, mbetëj në vlerësim të institucioneve të rivlerësimit për të çmuar nëse kjo ndërprerje do të ishte për shkak të mbushjes së moshës për pension apo për shkak të vullnetit të subjektit për të lënë detyrën përpara kohe/dorëheqjes së tij. Komisioni vendosi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Bilbil Mete, si dhe ndalimin e tij për t'u emëruar si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
21. Mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit, çështja e juridiksionit të rivlerësimit që i përket subjektit Bilbil Mete, në Kolegj u vendos që të zhvillohej në dhomë këshillimi, më datë 02.03.2021, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 49/2012, i ndryshuar").
22. Trupi gjykues, në seancën gjyqësore në dhomë këshillimi më datë 02.03.2021, konstatoi se vendimi i Komisionit është marrë mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, pa zhvilluar një seancë dëgjimore me praninë e subjektit, megjithëse ishte thirrur dhe njoftuar publikisht nga Komisioni një seancë dëgjimore në datën 02.12.2020. Për të garantuar të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit në kuptim të një procesi të rregullt ligjor, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, me shumicë votash vendosi shqyrtimin e çështjes në

seancë gjyqësore publike sipas nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, për të dëgjuar subjektin e rivlerësimit dhe për t’i dhënë mundësinë të japë shpjegime.

23. Në seancën gjyqësore publike të datës 16.03.2021, subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe dha parashtrimet e tij përpara trupit gjykues, duke konfirmuar njëkohësisht se u qëndron shkaqeve të ankimit të paraqitura në Kolegj.
24. Trupi gjykues përpara se të mbyllte shqyrtimin gjyqësor të çështjes, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në tri momente kryesore, bashkëlidhur ankimit, parashtrimeve dhe gjatë seancës gjyqësore publike në Kolegj, si në vijim.
- a. Aktet bashkëlidhur ankimit: i) *kërkesa e datës 17.08.2020, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë; ii) shkresa nr. {***} prot., datë 01.09.2020, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë; iii) kërkesa e subjektit të rivlerësimit e datës 01.10.2020, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme; iv) vërtetimi nr. {***}, datë 10.11.2020, i Prokurorisë së Përgjithshme; v) formulari për aplikim për pension pleqërie në e-albania, datë 27.11.2020; vi) shkresa “Vërtetim për aplikimin pensioni” nr. {***}, datë 17.12.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë; vii) certifikata personale e subjektit, lëshuar më datë 29.10.2020.*
- b. Aktet bashkëlidhur parashtrimeve¹: i) *kopje e njësuar me origjinalin e librezës së pensionit; ii) nxjerrje llogarie nga Credins Bank që konfirmon depozitim të fondeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në llogarinë e subjektit të rivlerësimit.*
- c. Aktet e paraqitura me kërkesë të trupit gjykues gjatë seancës gjyqësore publike: i) *kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë në datën 25.09.2020, për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit; ii) kopje e rekursit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit me nr. 107, datë 23.12.2020.*
25. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se hetimi administrativ që i përket subjektit të rivlerësimit Bilbil Mete, ka nisur më datë 15.11.2018 dhe ka përfunduar me marrjen e vendimit më datë 10.12.2020, pra hetimi ka zgjatuar më shumë se dy vjet. Ky fakt, në vlerësimin e Kolegjit, duhet të ishte trajtuar më gjerësisht nga Komisioni në vendimin e tij, për të argumentuar arsyet që çuan në një tejzgjatje të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, kur rezultoi që prej tij t’i jetë dhënë përgjigje vetëm pyetësorit standard të Komisionit e pyetësorit shtesë (nr. 2) që, si deklaroi subjekti në komunikimet me Komisionin, nuk kanë qenë as përfundimtare.
26. *Subjekti i rivlerësimit në ankim ka ngritur pretendimin se, referuar nenit 164 të ligjit nr. 96/2016, që parashikon se gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ai nuk gëzonte statusin e magjistratit, nuk duhet t’i ishte drejtuar KLP-së me kërkesën për mbarimin e statusit dhe meqë nuk e ka gëzuar asnjëherë statusin e magjistratit, vendimi i KLP-së dhe çdo vendim tjetër i lidhur me të është jokushtetues, i kundërligjshëm dhe i pavlefshëm.*
- Trupi gjykues në Kolegj, në analizë të këtij pretendimi, i referohet fillimisht përkufizimit të termit “magjistrat” në ligjin nr. 96/2016, i cili në nenin 2, germa “gj” e tij përcakton se

¹ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.02.2021 dhe me nr. {***} prot., datë 19.02.2021.

“magjistrat” është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të shkronjës “g” të këtij neni. Sa më sipër, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka qenë duke ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, ka fituar statusin e magjistratit për shkak të këtij ligji. Edhe pse në nenin 164, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016 parashikohet se gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, ky parashikim nuk do të thotë që gjyqtari apo prokurori në detyrë që nuk i është nënshtruar ende procesit të rivlerësimit, nuk gëzon statusin e magjistratit, por që ky status do të vijojë të mbahet vetëm nëse subjekti kalon me sukses procesin e rivlerësimit dhe konfirmohet në detyrë. Në vijim të këtij arsytimi, referuar nenit 169, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, që parashikon se *pjesa II, Kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit [...] pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1 janar 2019 [...]*, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit Bilbil Mete edhe pse nuk ka kaluar ende procesin e rivlerësimit, ka përfituar pagën sipas këtij parashikimi ligjor, që prej muajit janar 2019, siç përcaktohet në *vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, në masën 302.336 lekë (paga bruto), administruar në dosjen gjyqësore.*

Në mbështetje të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Bilbil Mete ka gëzuar statusin e magjistratit të fituar për shkak të ligjit nr. 96/2016, status i cili më pas është deklaruar i mbaruar me vendimin nr. 214, datë 15.10.2020, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pas kërkesës së paraqitur nga subjekti. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk gëzonte statusin e magjistratit, është i pabazuar. Për më tepër, nëse subjekti nuk do të ishte magjistrat, nuk do të kishte përfituar pagën e magjistratit sipas ligjit nr. 96/2016, nuk do t'i ishte drejtuar KLP-së me kërkesë dhe KLP-ja nuk do të deklaronte mbarimin e statusit, por do ta nxirrte jashtë kompetencës së tij trajtimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit.

27. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim se është larguar nga funksioni i prokurorit për shkak të daljes në pension sipas ligjit për sigurimet shoqërore dhe në kushtet kur nuk gëzonte statusin e magjistratit, mungonte dorëheqja dhe nuk mund të zbatohet parashikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nga analizimi i kuadrit ligjor që përcakton moshën e daljes në pension për magjistratët, trupi gjykues vëren se ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pikat 1, germa “c” dhe 5 të tij (para ndryshimeve ligjore të vitit 2019) parashikonte: *1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: [...] c) mbush moshën e pensionit. [...] 5. Magjistrati, i cili plotëson kushtet e parashikuara në ligj për të dalë në pension, i mbaron statusi i magjistratit në fund të muajit në të cilin ka mbushur moshën për pension. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës. Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 131, pika 1, germa “a” e Kushtetutës, në kuadër të verifikimit të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën, në vendimin nr. 34, datë 10.04.2017, paragrafët 50 dhe 63 ka arsyetuar:*

50. Bazuar në interpretimin literal të normës, Gjykata vlerëson se ligjvënësi përmes përdorimit të shprehjes “kushtet e parashikuara në ligj” e ka lidhur daljen në pension të magjistratit me plotësimin e kushteve dhe kriterëve që parashikon kuadri ligjor për pensionet në Republikën e Shqipërisë. Duke e analizuar rregullimin ligjor për pensionin e pleqërisë së magjistratëve në kontekstin e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës, në vlerësimin e Gjykatës zbatimi i normës ligjore, sipas formulimit aktual, ngre dyshime serioze për mosrespektimin e disa parimeve kushtetuese. Konkretisht, ligjvënësi, duke ulur moshën e daljes në pension nga 65 vjeç që ishte më parë, në një moshë të papërcaktuar shprehimisht, por të përcaktueshme rast pas rasti nga kuadri ligjor për pensionet e pleqërisë në RSH, ka krijuar një gjendje pasigurie juridike në radhët e magjistratëve, kjo për faktin se referuar bazës kushtetuese për miratimin e ligjit nr.7703,

datë 11.05.1993, i ndryshuar, ai është ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë, çka mbart rrezikun potencial që mund të ndryshohet në mënyrë të vazhdueshme, në varësi të politikave sociale dhe përshtatjen e skemës së pensioneve apo rishikimin e moshës së pensionit, me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Nga ana tjetër, prania e parashikimeve ligjore të paharmonizuara për pensionin e parakohshëm dhe atë të pleqërisë, ku për të dyja rastet moshë e përcaktuar nga ligjvënësi është 60 vjeç, si dhe rreziku i trajtimit të pabarabartë të gjyqtarëve për shkak të gjinisë, pasi, sipas legjislacionit në fuqi, moshë e daljes në pension e femrave ndryshon nga ajo e meshkujve, në vlerësimin e Gjykatës përbëjnë arsye bindëse për të arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesve për papajtueshmërinë me nenet 18 dhe 138 të Kushtetutës të nenit 64, pika 5 është i bazuar dhe duhet pranuar. [...]

63. Referuar një analize të harmonizuar të normave ligjore, Gjykata vëren se “shkaqet për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji” përfshijnë dorëheqjen me shkrim para Këshillit përkatës (neni 64), vërtetimin e kushteve të pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit (neni 66), mbushjen e moshës së pensionit (neni 64/5), shkarkimin nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji (pjesa V), si dhe vërtetimin e faktit të pamundësisë për të ushtruar detyrën (neni 67).

Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi ndër të tjera edhe nenin 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

Në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi me ligjin nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshimeve në ligjin nr. 96/2016 *Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, ndryshoi dhe nenin 64 në pikën 1, germa “c”, në pikat 4 dhe 5 si vijon: *1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: [...] c) mbush moshën 67 vjeç. [...] 4. Mandati i prokurorit të Prokurorisë së Posaçme mbaron në fundin e muajit në të cilin mbush moshën 67 vjeç, pavarësisht viteve që ai ka qenë në detyrë në këtë pozicion.*

5. Statusi i magjistratit mbaron në fund të muajit në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit mund t’i referohej ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në ato raste kur do të mungonte parashikimi ligjor në ligjin nr. 96/2016, për qëndrimin në detyrë të magjistratit, por në kushtet kur ky parashikim ekzistonte dhe ka ekzistuar në kohën që subjekti ka aplikuar për daljen në pension, pikërisht në nenin 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e ligjit të posaçëm, atëherë zbatohet ky i fundit, *lex specialis derogat legi generali*.

Trupi gjykues, në analizë të dispozitave ligjore, konkretisht nenit 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, vëren se, kur magjistrati mbush moshën 67, nuk i drejtohet me kërkesë Këshillit të Lartë të Prokurorisë për deklarimin e mbarimit të statusit për shkak të daljes në pension, pasi kjo iniciativë ndërmerret kryesisht nga këshilli, si organi përgjegjës i cili administron të dhënat për çdo prokuror në Republikën e Shqipërisë.

28. Në rastin objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit ka shprehur vullnetin për të mos vijuar më me ushtrimin e detyrës pas mbushjes së moshës 65 vjeç, edhe pse sipas përcaktimit ligjor të sipërtrajtuar, mbarimi i statusit për shkak të moshës do të deklarohet nga KLP-ja kur subjekti të mbushte moshën 67 vjeç. Vullneti i subjektit për të mos vijuar detyrën e prokurorit deri në mbushjen e moshës 67 vjeç, është shprehur në Komision nëpërmjet *e-mail-it* të datës 10.08.2020: *[...] sqaroj se pas 75 ditësh plotësoj moshën e pensionit, 65 vjeç, dhe pas disa ditësh do të paraqit para jush kërkesën që do të drejtoj në organet kompetente për dokumentet që duhet të plotësoj për daljen në pension, pasi nuk dëshiroj të vazhdoj të punoj pas kësaj moshe.* Duke vijuar më pas me kërkesën drejtuar sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, administruar me nr. {***} prot., datë 17.08.2020, duke e

informuar se bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, në datën 25.10.2020 mbush moshën e pensionit 65 vjeç dhe meqënëse ka më shumë se 44 vjet punë pa ndërprerje, nuk dëshiron të vazhdojë më tej pas mbushjes së moshës së pensionit. Si dhe me kërkesën e datës 25.09.2020 drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, dhe me aplikimin e datës 27.11.2020 pranë portalit qeveritar e-Albania: “Kërkesë për caktim pension pleqërie”.

29. Referuar rasteve të mbarimit të statusit të magjistratit të përcaktuara në nenin 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtushmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën 67 vjeç; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën, i vetmi rast kur statusi i magjistratit mbaron me vullnetin e tij, është kur jep dorëheqjen, pasi në të gjitha rastet e tjera procedura për mbarimin e statusit nis kryesisht nga KLP-ja.
30. Për sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit me veprime konkrete ka hequr dorë nga ushtrimi i detyrës së prokurorit, ndërkohë që ende nuk kishte mbushur moshën 67 vjeç të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, dhe mund të vazhdonte të ushtronte ende detyrën dhe të gëzonte statusin e magjistratit edhe për dy vjet të tjerë, trupi gjykues vlerëson se kur subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij ka lënë detyrën që ai ushtronte përkundrejt mundësisë ligjore për të vazhduar ushtrimin e funksionit, plotëson në këtë mënyrë kushtet për të kualifikuar këtë situatë faktike si ajo e parashikuar nga neni 64, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 96/2016, e cila titullohet si dorëheqje nga detyra.
31. Duke qenë se në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit për shkak të detyrës janë të gjithë gjyqtarë, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm [...], subjekti i rivlerësimit Bilbil Mete i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes, parashikuar nga neni 64, pika 1, germa “a” dhe neni 65 i ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të pashmangshme lidhet dhe me procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë dhe humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.
32. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve parashikojnë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke zbatuar në këtë rast nenin G të Aneksit të Kushtetutës, që parashikon ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar *gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*.
33. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të padrejtë pretendimin e subjektit se *Komisioni ka shkelur parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative pasi të drejtat apo interesat e ligjshme të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. Parimi i ligjshmërisë është shkelur pasi subjekti nuk gëzonte statusin e magjistratit sipas nenit 164, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016, pra është penalizuar pa ligj dhe se pika 2 e dispozitivit të vendimit bie ndesh me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut e për rrjedhojë është i pavlefshëm*.

34. Subjekti në ankim pretendon se ka dalë në pension në bazë të nenit 52 të Kushtetutës ku përcaktohet: *Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj, dhe nenit 31 dhe 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.* Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk pengohet nga e drejta e tij për të aplikuar dhe përfituar pension pleqërie me mbushjen e moshës 65 vjeç në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, siç dhe faktisht ka ndodhur, por në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 prej të cilit subjekti i rivlerësimit ka gëzuar statusin e magjistratit dhe gjithë përfitimet e tjera që rrjedhin prej tij, subjekti ka fituar dhe të drejtën për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës 67 vjeç. Ushtrimi i kësaj të drejte shoqërohet në të njëjtën kohë me mbajtjen e statusit të magjistratit dhe me detyrimin për t’iu nënshtruar dhe procesit të rivlerësimit. Nëse kjo e drejtë nuk ushtrohet nga subjekti i rivlerësimit, sjell si konsekuencë të vetme ligjore ndalimin sipas parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, por që nuk penalizon subjektin nga asnjë aspekt tjetër siç mund të jenë përfitimet që vijnë nga pensioni. Këtu vlen të theksohet që kjo konsekuencë ligjore nuk ka efekt për magjistratët të cilët e kanë kaluar procesin e rivlerësimit me sukses dhe zgjedhin të mos qëndrojnë në detyrë deri në moshën 67 vjeç.
- Refuzimi i subjektit të rivlerësimit për të vijuar ushtrimin e detyrës së prokurorit deri në këtë moshë, konsiderohet dorëheqje nga detyra e prokurorit/statusi i magjistratit në kuptim të nenit 64, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 96/2016 dhe shprehja e vullnetit të subjektit të rivlerësimit për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës si prokuror deri në mbushjen e moshës 67 vjeç do të konsiderohet si dorëheqje nga detyra që sjell si pasojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e ndalimit të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.
35. Gjithashtu, lidhur me pretendimin e subjektit në Komision se ka ngritur padi përpara Gjykatës së Apelit Administrativ, trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit është një proces i pavarur nga proceset e tjera gjyqësore administrative/civile, që subjekti i rivlerësimit mund të ketë ngritur për të kundërshtuar aktin administrativ të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit apo dhe në Gjykatën e Lartë, me objekt 1. *Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 214, datë 15.10.2020, me të cilin është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit për mua ankuesin. 2. Publikimi i vendimit të ndryshuar dhe plotësuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,* me palë ndërgjyqëse, paditës Bilbil Mete, i paditur Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe person i tretë, Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, nuk përbën pengesë për shqyrtimin e çështjes në Kolegj. Referuar juridiksionit të rivlerësimit, bazuar në nenin F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, objekt shqyrtimi në Kolegj është vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimmarrje e cila ka disponuar me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Përpos parashikimeve ligjore, edhe vullneti i subjektit të rivlerësimit ishte që gjykimi të vazhdonte dhe çështja të zgjidhej prej Kolegjit sepse shkaku ligjor i ankimit, zbatimi i nenit 164 të ligjit nr. 96/2016 sipas këndvështrimit të tij, nuk ishte ngritur në rekurs dhe mbi këtë argument Kolegji duhej të pranonte ankimin e tij. Gjatë seancës gjyqësore publike, subjekti u shpreh konkretisht se: *[...] kjo çështje mund të zgjidhet pa u shqyrtuar çështja në Gjykatën e Lartë, ku, me ritmet që po ecin mund të vazhdojë për shumë vite, dhe unë nuk ka pse të jem i penalizuar për shkak të mosfunksionimit të Gjykatës së Lartë sepse s’kanë asnjë lidhje. [...] ajo që është esenciale në rekursin që po dorëzohet, ka lidhje me faktin që aty nuk përmendet neni 164 dhe nuk ka lidhje fare me thelbin e gjykimit në KPA.*
36. Në kuadër të këtij procesi, i rëndësishëm është fakti i evidentimit të shprehjes së vullnetit të subjektit të rivlerësimit për të mos vijuar me procesin e rivlerësimit duke qenë subjekt i këtij procesi. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për subjektet e rivlerësimit ndaj të cilëve ka filluar hetimi administrativ dhe ky proces është ndërprerë me vullnetin e tyre të shprehur, sjellin

zbatimin e ndalimit të parashikuar nga pika 2 e nenit “G” të Aneksit të Kushtetutës, qëndrim i mbajtur në jurisprudencën² e deritanishme të Kolegjit.

37. Trupi gjykues, pasi analizoi çështjen në tërësi, shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi analizoi provat e administruara në këtë çështje, vlerëson se ndodhemi në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit Bilbil Mete për shkak të dorëheqjes nga detyra e prokurorit, për rrjedhojë gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e Komisionit në pikën 2 të dispozitivit të tij, që parashikon ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
38. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i Komisionit për zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bilbil Mete.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 23.03.2021.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

² Shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2020 dhe nr. 37, datë 17.12.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

MENDIM PAKICE

1. Ne – gjyqtarët Ardian Hajdari dhe Sokol Çomo – nuk jemi dakord me vendimin nr. 9, datë 23.03.2021, të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) për shqyrtimin e vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) që i përket subjektit të rivlerësimit Bilbil Mete. Nëpërmjet këtij vendimi, shumica e trupit gjykues vendosi të lërë në fuqi vendimin e sipërcituar të Komisionit. Ne gjyqtarët në pakicë kemi votuar për prishjen e vendimit të Komisionit për arsyet e mëposhtme.
2. Komisioni, megjithëse ishte njoftuar nga subjekti i rivlerësimit se ai kishte kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”) nr. 214, datë 15.10.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, me të cilin ishte vendosur deklarimi i mbarimit të statusit, për shkak dorëheqjeje, të magjistratit Bilbil Mete, me efekt nga data 31.10.2020, mori vendimin objekt gjykimi në Kolegj, pa pritur vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe, eventualisht, atë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Nga aktet e administruara në cilësinë e provës, në gjykim rezultoi se vendimi nr. 214, datë 15.10.2020, i KLP-së ishte ankimuar nga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Administrativ (çështja nr. {***} regjistri, datë 03.11.2020), me palë ndërgjyqëse: paditës Bilbil Mete, i paditur Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe person i tretë Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë. Objekti i padisë: *1. Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 214, datë 15.10.2020, me të cilin është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit për mua, ankuesin. 2. Publikimin e vendimit të ndryshuar dhe plotësuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.* Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin nr. 107, datë 23.12.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj. Subjekti i rivlerësimit në vijim, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër këtij vendimi, i cili rezultoi të jetë regjistruar pranë kësaj gjykate në datën 09.03.2021³. Nëpërmjet këtij rekursi, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në mënyrë alternative konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KLP-së nr. 214, datë 15.10.2020.
4. Në kushtet kur rezultoi e provuar gjatë gjykimit në Kolegj, se subjekti i rivlerësimit kishte ushtruar të drejtën për të paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit si më sipër, dhe në konsideratë të parashikimit të nenit 60, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, i ndryshuar, i cili parashikon: *Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi [...], ne, anëtarët në pakicë, bazuar në nenin 297, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, i kërkuam trupit gjykues pezullimin ex officio të gjykimit të çështjes, deri në përfundimin e kontrollit gjyqësor edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*
5. Për ne gjyqtarët në pakicë, pavarësisht se vendimi i sipërcituar i Gjykatës Administrative të Apelit ishte i formës së prerë, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet rekursit të ushtruar në Gjykatën e Lartë, kishte ngritur edhe pretendimin për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KLP-së nr. 214, datë 15.10.2020, mbi të cilin Komisioni kishte bazuar vendimmarrjen objekt i shqyrtimit në Kolegj, si dhe në referim të nenit 100, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon: “Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë [...], si dhe nga gjykata kompetente për

³Shih webfaqen e Gjykatës së Lartë: http://www.gjykataelarte.gov.al/gil_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2021-00569&ln=Lng1&uni=20210521115126134059352900712512

çështjet administrative sipas ligjit”, ekziston mundësia që Gjykata e Lartë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ të kundërshtuar. Në eventualitetin e kësaj situate faktike dhe ligjore, vendimi i KLP-së nr. 214, datë 15.10.2020, nuk do të sillte asnjë pasojë juridike dhe, si rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 322, datë 10.12.2020, do të bëhej i cenueshëm.

6. Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi ynë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes mund të ishte krejt i ndryshëm, në rast se gjykimi në Kolegj do të pezullohej deri në pritjen e vendimit të Gjykatës së Lartë lidhur me vlerësimin e vlefshmërisë së aktit administrativ të KLP-së.
7. Referuar situatës faktike dhe analizës ligjore të parashtruar si më lart, në kushtet kur shumica vendosi t’i japë fund shqyrtimit gjyqësor dhe të tërhiqej për marrjen e vendimit përfundimtar, pa pritur vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, e vetmja zgjidhje e drejtë në vlerësimin tonë ishte prishja e vendimit të Komisionit nr. 322, datë 10.12.2020, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, alternativë për të cilën edhe votuam.

GJYQTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi